



INTERNATIONAL MONETARY FUND



Njoftim për shtyp 16/310 AL
PËR SHPËRNDARJE TË MENJËHERSHME
28 qershor 2016

Fondi Monetar Ndërkombëtar
Washington, D.C. 20431 USA

**FMN-ja arrin marrëveshje në nivel stafi për përfundimin e shqyrtimit të tetë të
Marrëveshjes së Fondit të Zgjeruar për Shqipërinë**

Një mision i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), nën drejtimin e zonjës Anita Tuladhar, vizitoi Tiranën gjatë periudhës 15–28 qershor 2016, për të zhvilluar diskutime për shqyrtimin e tetë të Marrëveshjes së Fondit të Zgjeruar (EFF) për Shqipërinë. Në përfundim të vizitës, zonja Tuladhar mbajti këtë deklaratë:

“Ekipi i FMN-së arriti një marrëveshje në nivel stafi me autoritetet e Shqipërisë mbi politikën që nevojiten për të përfunduar shqyrtimin e tetë të EFF-së. Programi ekonomik i vendit po ecën përgjithësisht në drejtimin e duhur, duke shënuar ecuri të mirë në çuarjen përpara të reformave strukturore në fusha si legjislacioni për falimentimin dhe duke përmbytur të gjitha kriteret sasiore të performancës të përcaktuara nga programi. Megjithatë, rishfaqja e detyrimeve të prapambetura në qeverisjen qendrore, kryesisht në projektet e investimeve publike, paraqet një sfidë kryesore. Po ashtu, ka pasur vonesa në miratimin e planit të ristrukturimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

“Ekipi i Fondit pret që rimëkëmbja ekonomike të forcohet, duke parashikuar që, për vitin 2016, rritja e PBB-së të arrijë në 3,4 për qind, mbështetur nga një fluks i madh investimesh të huaja të drejtpërdrejta në sektorin energjitik dhe rritje graduale e kërkesës së brendshme, ndërkohë që politika monetare vijon të jetë lehtësuese. Inflacioni pritet të mbetet në nivele të ulëta, duke u rritur gradualisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2016, për të shënuar 1,8 për qind në fund të vitit, orientuar nga një rimëkëmbje graduale të çmimeve të naftës dhe ushqimit.

“Buxheti i vitit 2016 synon të arrijë një sufiçit primar prej 0,3 për qind të PBB-së. Të ardhurat nga tatimet ishin në përputhje me objektivat e vendosura gjatë pesë muajve të parë të vitit 2016, pavarësisht çmimeve jo të qëndrueshme të naftës dhe inflacionit të ulët, duke reflektuar pjesërisht rezultatet e para të përpjekjeve të qeverisë për përmirësimin e të ardhurave nga tatimet. Sidoqoftë, performanca e dobët e taksave vendore thekson se sa urgjente është vendosja e tatimit mbi pronën bazuar në vlerën e saj. Për të siguruar një

konsolidim të vazhdueshëm fiskal, do të jenë me rëndësi përpjekjet për zgjerimin e bazës tatimore si edhe forcimi i administratës tatimore. Po kështu, qeveria duhet të rrisë përpjekjet për të parandaluar grumbullimin e detyrimeve të reja të prapambetura dhe për të përmirësuar planifikimin dhe zbatimin e investimeve.

“Qëndrimi i Bankës së Shqipërisë për politikë monetare lehtësuese mbetet i duhuri dhe është në përputhje me objektivin e saj për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Zbatimi i shpejtë i strategjisë për zgjidhjen e çështjes së kredive nën standart do të jetë me rëndësi për fuqizimin e huadhënies për sektorin privat, edhe nëpërmjet përmirësimit në ekzekutimin e kolateralit. Sektori bankar mbetet tejet likuid dhe i kapitalizuar mirë.

“Bordi Ekzekutiv i FMN-së pritet të diskutojë për shqyrtimin e tetë në gusht 2016. Aprovimi i shqyrtimit do të mundësonte lëvrimin e 28,65 milion SDR (rreth 35,94 milion euro). Programi 36-mujor në formë EFF-je për Shqipërinë është miratuar më 28 shkurt 2014 (shih Njoftimin për shtyp 14/81).”